

VENDIM
Nr.855, datë 14.12.2011

PËR LEJIMIN E BOTIMIT, NË BULETININ E PROKURIMEVE PUBLIKE, TË NJOFTIMIT PËR LIDHJEN E KONTRATËS NDËRMJET DREJTORISË SË PËRGJITHSHME TË METROLOGJISË DHE SUBJEKTIT EKONOMIK FITUES NË TENDERIN E ZHVILLUAR ME OBJEKT “NDËRTIMI I SISTEMIT TË RRJETIT IT TË DPM-SË”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 75 të ligjit nr.9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Lejimin e Agjencisë së Prokurimit Publik për të botuar, në Buletinin e Prokurimit Publik, njoftimin e lidhjes së kontratës ndërmjet Drejtorisë së Përgjithshme të Metrologjisë, si autoritet kontraktor, dhe subjektit ekonomik fitues në tenderin me objekt: “Ndërtimi i sistemit të rrjetit IT të DPM-së”.

2. Ngarkohen Agjencia e Prokurimit Publik, Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës dhe Drejtoria e Përgjithshme e Metrologjisë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha